

Nr. 1450 dt. 08.04.2024

Në bazë të kërkesës elektronike të pranuar me dt.08.04.2024 nga Bordi i Drejtorëve të NPK "Trafiku Urban" SHA si dhe Statutit të NPK "Trafiku Urban" SHA, Kryeshefi Ekzekutiv merr këtë:

V E N D I M

1. Anulohen konkurset me nr.1412, nr.1410, nr.1406, nr.1409, nr.1407, nr.1408, nr.1405, nr.1411 dhe 1413 te datës 03.04.2024.
2. Anulimi sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të kërkesës elektronike të pranuar me dt. 08.04.2024 nga Bordi i Drejtoreve të NPK "Trafiku Urban" SHA.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Bordi i Drejtoreve të NPK "Trafiku Urban" SHA bazuar në Kompetencat që i përshkruhen në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Statutin e NPK "Trafiku Urban" dhe Rregulloren e punës së BD të NPK "Trafiku Urban" Sh.A. Prishtinë, me dt. 08.04.2024 përmes kërkesës elektronike ka kërkuar nxjerrjen e menjëhershëm të vendimit për anulimin e konkurseve me nr.1412, nr.1410, nr.1406, nr.1409, nr.1407, nr.1408, nr.1405, nr.1411 dhe 1413 të datës 03.04.2024 me arsyetimin:

" Gjendjen financiare jo të mirë të Ndërmarrjes në dy muajt e parë te viti 2024, në planin e biznesit për vitin 2024, protokoluar me nr. 4050 të dates 31.10.2023 tek Drejtoria e Administratës / Burimet njerzore nuk kemi një prezentim lidhur me nevojat për rritjen e stafit, madje aty parashikohen trajnime për stafin aktual gjë që do të ndihmonte edhe organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës me Rregulloren e re (për aq sa BD ka informacione trajnime të tilla nuk ka pasë deri më tani). Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës është duke u punuar. Rekrutimi me staf të ri duhet të bëhet vetëm në bazë të stabilitetit dhe qendrueshmërisë financiare të Ndërmarrjes (një matje të tillë nga BD ende nuk kemi, përveç pasqyrave financiare të prezentuara në Raportet për muajt Janar dhe shkurt 2024 të cilat lënë për të dëshiruar). "

Andaj bazuar në kërkesën e Bordit të Drejtoreve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryeshef Ekzekutiv
Burim

Për:



Këshillë Juridike: Kundër vendimit, pala e pakënaqur, mund të paraqes ankesë të Komisionit i Ankesave, në afat prej tetë (8) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë/ Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 23